

Ademi, Zeqiri dhe Blerimi u nisën nga pylli për në fshat **[Obria e Epërme/Gornje Obrinje]** për të marrë disa rroba dhe ushqime për familjarët e vet. Duke iu afruar mëhallës së vet, ata e vërejtën një kolonë autobлиндash serbe që po lëvizte drejt fshatit nga drejtimi i Likocit/Likovac. Kur arritën në mëhallën e vet, e panë një polic në hyrje të shtëpisë së Beqir Deliu. Një polic tjetër qëndronte para shtëpisë. Menjëherë ia dhanë vrapit. Njëri nga policët u bërtiti që të ndaleshin, e pastaj ka shtënë drejt tyre. Blerimi arriti që të largohej me vrap nga vendi i ngjarjes. Përderisa vraponte, i kujtohet se në prapavijën e tij e kishte vërejtur Ademin e qëlluar me plumba në këmbë. Dy ditë më vonë, kur forcat serbe u tërhoqën nga rajoni, vëllai i Ademit, Imeri, dhe Bashkim Deliu u kthyen në fshat. Në *Mëhallën Deliu*, në hyrje të oborrit të Ademit, e gjetën trupin e tij. I kishte plagët nga plumbat nëpër tërë trupin. Pas pak, e kanë gjetur edhe trupin e Zeqirit. Ishte afro 300 metra larg atij të Ademit. Në shtëpinë e Bashkimit, i zbuluan mbetjet e karbonizuara mortore të babait të tij Fazliut. Që të tre u varrosën në fushën që ishte pronë e Imerit më 30.09.1998. Një vjet më vonë, në përvjetorin e vrasjes së tyre, mbetjet e tyre mortore janë rivarrosur në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Obrinë e Epërme/Gornje Obrinje.

Burimet: deklarata I.DFDH-33503; deklarata B.D, FDH-8889; deklarata I.D, FDH-8883; deklarata I.D, FDH-16499; HRW, *Po naređenju...*, 80, 216, 582; ICTY, IT-05-87 (M. Milutinović dhe të tjerë), EX.6D00700, FDH-33284; deklarata H.D, FDH-8881; deklarata, R.D, FDH-8882; deklarata I.D, FDH-8883; deklarata I.D, FDH-16499; deklarata I.D, FDH-8886.

Afrim (Fazli) Hajdaraj

(14.09.1975, shqiptar nga Obria e Epërme/Gornje Obrinje, komuna e Gllgocit/Glogovac, pjesëtar i UÇK-së)

Vesel (Mursel) Demaku

(12.10.1947, shqiptar nga Obria e Epërme/Gornje Obrinje, komuna e Gllgocit/Glogovac, mësues, shtatë fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Valdet (Salih) Xhemajli

(19.10.1976, shqiptar nga Obria e Epërme/

Gornje Obrinje, komuna e Gllgocit/Glogovac, pjesëtar i UÇK-së)

Afrimi, Veseli dhe Valdeti kanë qenë pjesëtarë të UÇK-së. Valdeti aderoi në UÇK në muajin tetor të vitit 1997, ndërkaq Afrimi në fillim të muajit mars të vitit 1998. Që të gjithë kanë rënë në betejë me forcat serbe, e cila u zhvillua në fshatin **Obria e Epërme/Gornje Obrinje** më **26.09.1998**. Po atë ditë, bashkëluftëtarët e tyre i kanë varrosur Afrimin, Veselin dhe Valdetin në pyll, në të njëjtin vend ku ata edhe kishin rënë në betejë. Dy ditë më vonë, familjarët i kanë rivarrosur trupat e tyre në varrezat e Obrisë së Epërme/Gornje Obrinje. Pas përfundimit të luftës, mbetjet mortore të Veselit dhe Valdetit janë varrosur përfundimisht në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Obrinë e Epërme/Gornje Obrinje, përderisa mbetjet mortore të Afrimit ende prehen në varrezat lokale.

Burimet: deklarata A.H, 28126; deklarata S.Xh, 32012; deklarata Z.D, 32013; deklarata I.D, FDH-33503; J. Martinsen, *Registri...*, FDH-26092; KMDLNI, *Buletini*, num. 9, tetordhjetor 1998, 117, FDH-23857; ICTY, IT-05-87 (M. Milutinović dhe të tjerë), EX.6D00700, FDH-33284.

Pajazit (Rrustem) Deliu

(8.10.1929, shqiptar nga Obria e Epërme/Gornje Obrinje, komuna e Gllgocit/Glogovac, tetë fëmijë)

Ali (Veli) Deliu

(11.02.1930, shqiptar nga Obria e Epërme/Gornje Obrinje, komuna e Gllgocit/Glogovac, punëtor ndërtimor, nëntë fëmijë)

Hava (Imer) Elshani

(1936, shqiptare nga Obria e Epërme/Gornje Obrinje, komuna e Gllgocit/Glogovac, amvise)

Hamide (Liman Elshani) Deliu

(1938, shqiptare nga Obria e Epërme/Gornje Obrinje, komuna e Gllgocit/Glogovac, amvise, pesë fëmijë)

Lumnije (Bajram) Deliu

(3.02.1969, shqiptare nga Obria e Epërme/Gornje Obrinje, komuna e Gllgocit/Glogovac, amvise)

Zahide (Adem Bajraktari) Deliu

(1971, shqiptare nga Obria e Epërme/Gornje